



V E N D I M

K.P.P 593/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-72866-05-31-2018 me objekt: “Pastrim dhe largim i mbetjeve”, me fond limit 55,705,870 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.06.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.

Ankimues:

“Rej” shpk
Banesë private pranëish Komunës Udenisht Pogradec

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Sarande
Rruga “Abedin Dino”, Lagjia nr 1, Sarande

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.05.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-72866-05-31-2018 me objekt: “*Pastrim dhe largim i mbetjeve*”, me fond limit 55,705,870 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.06.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.

II.2. Në datën 05.06.2018 operatori ekonomik “Rej” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

- *Në kriteret e vecanta të kualifikimit kërkohet: Shërbime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 22 282 348 lekë pa TVSH, të kryera gjatë tri viteve të fundit.*

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me: a) situacionet dhe faturat tatimore perkatese te konfirmuara për shërbimet e kryera; b) vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar*

kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar; c) vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.

- Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik duhet të paraqesë: a) faturat tatimore perkatese, të konfirmuara (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara)dhe situacionet për shërbimet e kryera; b) vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.

Rregullat e Prokurimit Publik parashikojnë se do të quhet dokumentacion i vlefshëm shërbime të kryera gjatë tre viteve të fundit dhe jo kontrata të përfunduara gjatë tre viteve të fundit. LPP në asnjë rast nuk ndalon lidhjen e kontratave shumëvjeçare si dhe Marrëveshje Kuadër deri në 4 vjet (ashtu si në rastin konkret) ndaj edhe për vërtetimin e eksperiencës kërkohen prova dhe dëshmi se operatorët ekonomikë kanë përfunduar shërbimin me sukses brenda një ose disa kontratave me kushtin e vetëm që shërbimi të jetë kryer brenda tre viteve të fundit. Gjithashtu nga praktika si në shqipëri dhe në vende të tjera ato të kryerjes së shërbimit të pastrimit të qyteteve janë kryesisht kontrata disavjeçare dhe në raste të rralla kontrata njëvjeçare pasi lidhet me lementin e investimit të shoqërive pjesmarrëse në makineri, staf pajisje etj në rast fitimi të kontratës. Shoqëritë të cilat zotërojnë kontrata disavjeçare nuk mund të penalizohen se nuk gëzojnë eksperiencë të ngjashme në ofrimin e shërbimit të pastrimit për periudhën të cilën ato kanë kryer shërbim. Kontratat e shërbimeve vecanërisht ato të ofrimit të shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane nuk kanë një akt finaltë pranimit të tyre sic është kolaudimi në kontratat e punëve publike. Me nënshkrimin e faturës tatimore nga supervizori i shërbimit shërbimet janë pranuar nga ana e AK (pa penalitete). Ndaj mendojmë se në zbatim të nenit 46 pika 1 dhe nenit 28 autoriteti juaj kontraktor nuk mund të kufizojë pjesmarrjen duke kërkuar domosdoshmërisht që kontratat të jenë të përfunduara por që shërbimi për periudhën e dorëzuar të jetë i përfunduar dhe i pranuar rregullisht nga ana e AK duke përmbushur edhe kushtet e parashikuara nga ligji në lidhje me dëshminë për eksperiencë të ngjashme. **Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin 157/2017 .** Sa më sipër kërkojmë pranimin në lidhje me këtë pikë. **Pranohet nga ak**

- Në DST kërkohet: Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori I shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për qytetin e Sarandes, I cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:
 - a) Librezëpune (përkatëse)
 - b) Diplomë
 - c) CV përkatëse
 - d) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar mësipër,Drejtuesi Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punë dhënësi imëparshem për eksperiencën e punës si drejtues teknik.

Vendosja e këtij kriteri është tendencioz me qëllim skualifikimin e sa më shumë operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Mbështetur në VKM nr.42 datë 16.01.2008 kreu IV përcaktohet qartë se kur një inxhinier mund të bëhet drejtues teknik i cili ka si detyrë që të realizojë projektet në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Personi i cili fiton statusin e Drejtuesit Teknik në një shoqëri ka tagrin e plotë të realizojë cdo kontratë në fushën për të cilën është diplomuar dhe për të cilin ka funksionin e Drejtuesit Teknik. Nuk mund të përjashtohet nga procedurat e prokurimit një operator ekonomik i cili ka drejtues teknik për të realizuar këtë kontratë që prokurohet por nuk plotëson kriterin që ky drejtues nuk ka punuar për 5 vjet në kontratën e shërbimit të pastrimit. Theksojmë edhe një herë bazuar në VKM nr.42 datë 16.01.2008 se inxhinieri i cili fiton statusin e Drejtuesit Teknik në profesionin që është diplomuar ka aftësinë e duhur për të realizuar cdo kontratë publike ose private për profesionin për të cilin është diplomuar. Këkrojmë modifikimin e këtij kriteri diskriminues duke hequr përkufizimin “një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit”, bazuar në VKM nr.42 datë 16.01.2008 dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 neni 28. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në një vendim të ngjashëm nr.748/2017.

- Në DST kërkohet: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 vit, për punonjësit si mëposhtë:

1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV dhe librezë pune. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të ketë ne stafin e tij inxhinierin mekanik i cili të vertetohet me dokumentacionin sa më siper cituar).

1 (një) Inxhinier Mjedis, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, librezë pune dhe Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të ketë ne stafin e tij inxhinierin e mjedisit i cili të vertetohet me dokumentacionin sa më siper cituar).

Kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë se stafi teknik i cituar më sipër duhet të jetë i siguruar për një vit në listpagesa nuk është i mbështetur në ansjën në VKM nr.914 datë 29.12.2014 dhe LPP. Ky kriter nuk stimulon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë kjo në kundërshtim me LPP pasi një OE i ka pjesë të stafit teknik personat e cituar më sipër por nuk i ka të siguruar për një periudhë një vjeçare nuk mund të marrë pjesë në këtë procedurë edhe pse plotëson më së miri kriterin e stafit teknik. Gjithashtu duhet të kemi parasysh se edhe Kodi i Punës i cili rregullon marrëdhëniet midis subjekteve private punëdhënës dhe punëmarrës. Në nenin 8 pika 1 e KP madje parashikohet ndalimi i punës së detyruar gjatë gjithë kohës së saj. Në këtë mënyrë ju nuk mund të detyroni subjektet të mbajnë në listpagesat e tyre inxhinierë apo pjesë të stafit teknik vetëm e vetëm që të përmbushet kriteri 1 vjeçar në listpagesa pasi jeni në kundërshtim me lirinë kontraktuale të parashikuar nga kodi i

punës. Akoma më tej kjo kërkesë del dhe përtej natyrës njerzore ku inxhinierët apo pjesë e stafit teknik mund të largohen nga puna për arsye shëndetësore dhe kjo nuk mund të penalizojë një shoqëri e cila gëzon kapacitete teknike organizative dhe financiare për realizimin me sukses të kontratës. Nëse autoriteti juaj kontraktor kërkon të provojë vijimësi në marrëdhënie pune të një inxhinieri të një profili të caktuar atëherë gjithashtu ju keni mundësinë të modifikoni kriterin ku të kërkonti që të vërtetohet që gjatë një viti të ketë figuruar në listpagesë një inxhinier pra të vërtetohet që edhe para punësimit të një inxhinieri konkret ka disponuar një inxhinier tjetër të të njëjtit profil. Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke hequr termin që stafi teknik të figurojë në listpagesa për një vit. Këtë qëndrim ka mbajtur KPP edhe në vendimin nr.748/2017.

- Në DST kërkohet: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë. Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: Kontratë Pune e vlefshme, UrdhërMjeku, CV, Librezë Pune, Diplomënpërkatësë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm.. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të ketë në stafin e tij mjekun i cili të vërtetohet me dokumentacionin sa më sipër cituar).

Aktualisht shfaqet e nevojshme disponueshmëria e mjekut vetëm në disa ndërmarrje specifike dhe për numër minimalisht 500 punonjës ndërkohë ju keni kërkuar vetëm 16 punonjës. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP në vendimin nr.28/2018 Kërkojmë heqjen e kriterit.

- Në DT kërkohet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:
 - a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-11ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **3 copë**;
 - b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 1ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 copë**;
 - c) Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një)copë**.
 - d) Makine transportuese veteshkarkuese për heqjen e mbetjeve inerte të vëllimshme me peshe mbajtëse jo më pak se 3 ton **2 (dy) cope**.
 - e) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m3, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub

aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;

- f) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **1 (një) copë**;

Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – e, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- a) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi).
- b) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekti këti jprokurimi).
- c) Për mjetet qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- d) Per mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; - kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar(para , prapa ,anash) në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Përcaktimi nga AK Bashkia Sarandë i vitit të prodhimit të makinerive është një kriter diskriminues dhe është në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPP. Makineritë kolaudohen nga kompania SGS Albania e cila përcakton nëse makina plotëson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave të motorit në ajër etj) sipas legjislacionit në fuqi për të qarkulluar në rrugët e RSH. Kur makineritë kolaudohen në bazë të rregullave të përcaktuara në manualin e kontrollit të mjeteve nga shoqëria SGS Albania atherë këto makineri mund të përdoren në RSH. Vendosja e vitit të prodhimit nga AK si kusht skualifikues është një kriter diskriminues i pabzuar në VKM nr.914 datë 29.12.2014 dhe LPP. Kërkojmë heqjen e kriterit për vitin e prodhimit të mjeteve jo më pak se viti 2010. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP në vendimin KPP 748/2017.

- AK ka kërkuar provueshmërinë e disponueshmërisë së mjeteve ose me pronësi ose me qera. Ndërkohë nuk keni dhënë mundësinë e disponueshmërisë së mjeteve që mund të vihen në dispozicion me forma të ndryshme dhe konkretisht me anë të kontratës së porosisë parashikuar nga neni 914 i kodit civil ose kontratave të blerjes së mjeteve me kusht. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP në vendimin 28/2018 . Kërkojmë modifikimin e kriterit duke hequr vitin e prodhimit të mjeteve dhe paraqitjen e mjeteve me kontratë porosie ose blerje me kusht.

Sa më sipër kërkojmë pranimin e ankesës.

II.3. Në datën 08.06.2018 me shkresën nr.1507/1 prot, autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.4. Në datën 14.06.2018 pala ankimuese “Rej” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.1658/1 prot., datë 25.06.2018 protokolluar me tonën me nr.1128/2 datë 29.06.2018 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” shpk për modifikimin e kriterit “Shërbime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 22 282 348 lekë pa TVSH, të kryera gjatë tri viteve të fundit. **Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:** Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me: a) situacionet dhe faturat tatimore perkatese te konfirmuara për shërbimet e kryera; b) vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar; c) vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve. Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik duhet te paraqese: a) faturat tatimore perkatese, te konfirmuara (ku te shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara)dhe situacionet për shërbimet e kryera; b) vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 3.3.1 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Shërbime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 22 282 348 lekë pa TVSH, të kryera gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me: a) situacionet dhe faturat tatimore perkatese te konfirmuara për*

shërbimet e kryera; b) vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar; c) vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.

- Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik duhet të paraqesë: a) faturat tatimore perkatese, të konfirmuara (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara) dhe situacionet për shërbimet e kryera; b) vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.

III.1.2. Referuar kthim përgjigjes drejtuar ankimesit lidhur me këtë kriter KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka pranuar këtë pretendim të ankimesit duke argumentuar si vijon: Në lidhje me pikën 3.3. kapaciteti teknik pika 1 AK gjykon se pretendimi i ngritur nga OE qëndron dhe kërkesa e tij në lidhje me këtë pikë pranohet. AK do të bëjë ndryshimet në DST. Ky kriter ishte: Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me: a) situacionet dhe faturat tatimore perkatese të konfirmuara për shërbimet e kryera; b) vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar; c) vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.

Do të bëhet: Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me: a) situacionet dhe faturat tatimore perkatese të konfirmuara për shërbimet e kryera; b) vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e punimeve të kësaj kontrate ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar; c) vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.

III.1.3. Në kushtet kur ky pretendim i ankimesit është pranuar KPP nuk shprehet më tej lidhur me këtë kriter. Por nga verifikimet në SPE, KPP konstaton se nuk është publikuar shtojcë lidhur me modifikimin e dokumentave të procedurës objekt ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit në përputhje me konstatimet në shkresën e sipërcituar si dhe në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]* Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.

Sa më sipër, në kushtet kur ky pretendim i ankimuesit është pranuar nga autoriteti kontraktor, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në përputhje me pretendimet e ankimuesit dhe publikimin e tij në përputhje me nenin 42 të sipërcituar.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” shpk për modifikimin e kriterit “Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori I shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për qytetin e Sarandes, I cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- e) Librezëpune (përkatëse)
- f) Diplomë
- g) CV përkatëse
- h) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar mësipër, Drejtuesi Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punë dhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës si drejtues teknik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 3.3. “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori I shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për qytetin e Sarandes, I cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- i) Librezëpune (përkatëse)
- j) Diplomë
- k) CV përkatëse
- l) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar mësipër, Drejtuesi Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punë dhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës si drejtues teknik.

III.2.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.2.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikon shprehimisht se:

5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni gjykon se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në këtë kuptim kërkesa e autoritetit kontraktor që Drejtuesi Teknik i shoqërisë duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shmang pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit. Kjo e drejtë (drejtues teknik) fitohet pasi personi e ka përvojën në punë për periudhën e përcaktuar në VKM-në nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplonimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, Kreu IV “Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajueshmëria me këtë detyrë”, pika 1, ku parashikohet shprehimisht:

“Drejtuesi teknik i shoqërisë

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi.

b) *Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.*

c) *Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës individuale të punës.*”

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës publike objekt prokurimi. Në rastin konkret, referuar specifikimeve teknike si dhe termave të referencës të dokumentave të tenderit, kërkesa e autoritetit kontraktor në lidhje me vitet e eksperiencës së drejtuesit teknik në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit i tejkalon përmasat e kontratës që do të prokurohet, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të mësipërm, duke hequr përcaktimin “*në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit*”, duke lënë kërkesën për eksperiencë 5 vjetecare të Drejtuesit teknik.

Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” shpk për modifikimin e kriterit “*Në DST kërkohet: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 vit, për punonjësit si mëposhtë: 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV dhe librezë pune.*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të ketë në stafin e tij inxhinierin mekanik i cili të vërtetohet me dokumentacionin sa më siper cituar).

1 (një) Inxhinier Mjedis, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, librezë pune dhe Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të ketë në stafin e tij inxhinierin e mjedisit i cili të vërtetohet me dokumentacionin sa më siper cituar).

Kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë se stafi teknik i cituar më sipër duhet të jetë i siguruar për një vit në listpagesa nuk është i mbështetur në ansjë nen të VKM nr.914 datë 29.12.2014 dhe LPP. Ky kriter nuk stimulon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë kjo në kundërshtim me LPP pasi një OE i ka pjesë të stafit teknik personat e cituar më sipër por nuk i ka të siguruar për një periudhë një vjetecare nuk mund të marrë pjesë në këtë procedurë edhe pse plotëson më së miri kriterin e stafit teknik. Gjithashtu duhet të kemi parasysh se edhe Kodi i Punës i cili rregullon marrëdhëniet midis subjekteve private punëdhënës dhe punëmarrës. Në nenin 8 pika 1 e KP madje parashikohet ndalimi i punës së detyruar gjatë gjithë kohës së saj. Në këtë mënyrë ju nuk mund të detyroni subjektet të mbajnë në listpagesat e tyre inxhinierë apo pjesë të stafit teknik vetëm e vetëm që të përmbushet kriteri 1 vjetecar në listpagesa pasi jeni në kundërshtim me lirinë kontraktuale të parashikuar nga kodi i punës. Akoma më tej kjo kërkesë del dhe përtej natyrës njerzore ku inxhinierët apo pjesë e stafit teknik mund të largohen nga puna për arsye shëndetësore dhe kjo nuk mund të penalizojë një shoqëri e cila gëzon kapacitete teknike organizative dhe financiare për realizimin me sukses të kontratës. Nëse autoriteti juaj kontraktor kërkon të provojë vijimësi në marrëdhënie pune të një inxhinieri të një profili të caktuar atherë gjithashtu ju keni mundësinë të modifikoni kriterin ku të kërkon që të vërtetohet që gjatë një viti të ketë figuruar në listpagesë një inxhinier pra të vërtetohet që edhe para punësimit të një

inxhinieri konkret ka disponuar një inxhinier tjetër të të njëjtit profil. Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke hequr termin që stafi teknik të figurojë në listpagesa për një vit. Këtë qëndrim ka mbajtur KPP edhe në vendimin nr.748/2017”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 3.3. “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 vit, për punonjësit si mëposhtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV dhe librezë pune. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të ketë ne stafin e tij inxhinierin mekanik i cili të vertetohet me dokumentacionin sa më sipër cituar).
- 1 (një) Inxhinier Mjedis, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, librezë pune dhe Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. . (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të ketë ne stafin e tij inxhinierin e mjedisit i cili të vertetohet me dokumentacionin sa më sipër cituar).

III.3.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.3.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në pikën 5, po këtu, prashikohet shprehimisht:

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

III.3.4. Komisioni gjykon se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.3.5. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimesit lidhur me këtë kriter sqarohet se: *Autoriteti kontraktor në këtë kriter ka kërkuar që operatori ekonomik të ketë patur pjesë përbërëse të stafit të tij inxhiniera të këtij profili dhe jo domosdoshmërisht të njëjtë persona.*

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës publike objekt prokurimi. Në rastin konkret, KPP gjykon se kërkesa për pasqyrimin në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (një) vit të stafit teknik, është vendosur për të krijuar një panoramë të përgjithshme lidhur me kapacitetet profesionale që disponojnë operatorët ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar duhet të vërtetojnë se zotërojnë personelin e nevojshëm, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet nga operatori ekonomik, që ky i fundit disponon stafin teknik, duke treguar kapacitetet e këtij të fundit në lidhje me personelin, por jo detyrimisht që në listpagesat në fjalë të figurojnë të njëjtat emra që lidhen me këto pozicione gjatë gjithë periudhës të përcaktuar më sipër; pasi në stafin e operatorëve ekonomikë mund të ketë lëvizje të punonjësve. Këtë qëllim ka pasur edhe autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterit cka konfirmohet edhe në shkresën kthim përgjigje drejtuar ankimesit të sipërcituar.

Pra periudha e kërkuar në listpagesa në thelb nuk është kërkesë e ekzagjeruar pasi i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor për përfundimin e ofertës më të mirë dhe më të leverdisshme për kryerjen e shërbimit të kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit, por AK duhet të modifikojë kriterin e kualifikimit duke lejuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë me dokumentacion konkret se kanë pasur apo kanë në vijimësi në stafin e tyre për një vit inxhinierat në profilet e sipërcituara.

Pretendimi i ankimesit qëndron pjesërisht.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimesit “Rej” shpk mbi modifikimin e kriterit “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë. Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: Kontratë Pune e vlefshme, UrdhërMjeku, CV, Librezë Pune, Diplomënpërkatësë. Në rastin e bashkimit të

operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm.. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të ketë ne stafin e tij mjekun i cili të vërtetohet me dokumentacionin sa më siper cituar). Aktualisht shfaqet e nevojshme disponueshmëria e mjekut vetëm në disa ndërmarrje specifike dhe për numër minimalisht 500 punonjës ndërkohë ju keni kërkuar vetëm 16 punonjës. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP në vendimin nr.28/2018 Kërkojmë heqjen e kriterit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 3.3. “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë. Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: Kontratë Pune e vlefshme, UrdhërMjeku, CV, Librezë Pune, Diplomënpërkatësë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm.. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të ketë ne stafin e tij mjekun i cili të vërtetohet me dokumentacionin sa më siper cituar).

III.4.2. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me këtë pikë të ankesës KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka pranuar këtë pretendim të ankimuesit duke argumentuar si vijon: Për pikën e katërt të ankesës KSHA referuar edhe vendimeve të KPP e pranon këtë kërkesë dhe do të heqë këtë si kriter. Ky veprim do të pasqyrohet edhe me ndryshimet që do të bëhen në dokumentat standarte të procedurës së shpallur.

III.4.3. Në kushtet kur ky pretendim i ankimuesit është pranuar KPP nuk shprehet më tej lidhur me këtë kriter. Por nga verifikimet në SPE, KPP konstaton se nuk është publikuar shtojcë lidhur me modifikimin e dokumentave të procedurës objekt ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit në përputhje me konstatimet në shkresën e sipërcituar si dhe në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*” Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për

dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.

Sa më sipër, në kushtet kur ky pretendim i ankimesit është pranuar nga autoriteti kontraktor, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në përputhje me pretendimet e ankimesit dhe publikimin e tij në përputhje me nenin 42 të sipërcituar.

III.5. Lidhur me pretendimin e ankimesit “Rej” shpk Në DT kërkohet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- g) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-11ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **3 copë**;*
- h) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 1ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 copë**;*
- i) *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një)copë**.*
- j) *Makine transportuese veteshkarkuese per heqijen e mbetjeve inerte te vellimshme me peshe mbajtese jo me pak se 3 ton **2 (dy) cope**.*
- k) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m3, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;*
- l) *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **1 (një) copë**;*

Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – e, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- f) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi).
- g) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekti këti jprokurimi).
- h) *Për mjetet qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*
- i) *Per mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; - kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*

- j) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar (para , prapa , anash) në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Përcaktimi nga AK Bashkia Sarandë i vitit të prodhimit të makinerive është një kriter diskriminues dhe është në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPP. Makineritë kolaudohen nga kompania SGS Albania e cila përcakton nëse makina plotëson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave të motorit në ajër etj) sipas legjislacionit në fuqi për të qarkulluar në rrugët e RSH. Kur makineritë kolaudohen në bazë të rregullave të përcaktuara në manualin e kontrollit të mjeteve nga shoqëria SGS Albania atëherë këto makineri mund të përdoren në RSH. Vendosija e vitit të prodhimit nga AK si kusht skualifikues është një kriter diskriminues i pabzuar në VKM nr.914 datë 29.12.2014 dhe LPP. Kërkojmë heqjen e kriterit për vitin e prodhimit të mjeteve jo më pak se viti 2010. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP në vendimin KPP 748/2017.

- AK ka kërkuar provueshmërinë e disponueshmërisë së mjeteve ose me pronësi ose me qera. Ndërkohë nuk keni dhënë mundësinë e disponueshmërisë së mjeteve që mund të vihen në dispozicion me formë të ndryshme dhe konkretisht me anë të kontratës së porosisë parashikuar nga neni 914 i kodit civil ose kontratave të blerjes së mjeteve me kusht. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP në vendimin 28/2018 . Kërkojmë modifikimin e kriterit duke hequr vitin e prodhimit të mjeteve dhe paraqitjen e mjeteve me kontratë porosisë ose blerje me kusht”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 3.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- m) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-11ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **3 copë**;
- n) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 1ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 copë**;
- o) Makinë transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**.
- p) Makinë transportuese vetëshkarkuese për heqjen e mbetjeve inerte të vëllimshme me peshe mbajtëse jo me pak se 3 ton **2 (dy) cope**.
- q) Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;

r) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **1 (një) copë**;

2. Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – e, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- k) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi).
- l) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekti këti jprokurimi).
- m) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- n) Për mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; - kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- o) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar (para , prapa , anash) në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

III.5.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.5.3. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.5.4. Referuar Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 përcaktohet:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Në lidhje me kërkimin e autoritetit kontraktor mbi vitin e prodhimit të mjeteve, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis. Një kriter i tillë ka për qëllim uljen e nivelit të ndotjes që shkaktohet në ajër dhe mbi të gjitha është vendosur në harmoni me kriterin tjetër të përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi prezencën e një inxhinieri mjedisi si dhe me natyrën dhe objektin e kësaj procedure që është “Pastrimi dhe largimi i mbeturinave”. Me qëllim respektimin e normativës së ndotjes në ambjent, meqenëse janë mjete teknologjike që punojnë me kohë të zgjatur në qytet dhe për të pasur një nivel të ulët ndotjeje në respektim dhe të normativave të komunitetit europian dhe udhëzimeve të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, KPP e gjen kriterin e vendosur të drejtë dhe proporcional me objektin e kontratës.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Gjithashtu lidhur me pretendimin e ankimuesit se *nuk keni dhënë mundësinë e disponueshmërisë së mjeteve që mund të vihen në dispozicion me forma të ndryshme dhe konkretisht me anë të kontratës së porosisë parashikuar nga neni 914 i kodit civil ose kontratave të blerjes së mjeteve me kusht*” KPP e gjen të pabazuar. KPP gjykon se format e tjera të disponimit të mjeteve përveç kontratës së qerasë apo të pronësisë së mjeteve sic janë ato për blerjen me kusht apo porosisë nuk mund të aplikohen në rastin konkret. Autoriteti kontraktor kërkon të krijojë bindjen në ditën e hapjes së ofertave që mjetet disponohen nga ana e autoritetit kontraktor në një nga format ligjore atë të qerasë apo në pronësi por nuk mund të krijojë këtë bindje me anë të një kontrate me kusht sikundër pretendon ankimuesi apo akoma më tej me një kontratë porosie. KPP gjykon se operatorët ekonomikë në ditën e hapjes së ofertave duhet të provojnë para autoritetit kontraktor se plotësojnë kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Këto kapacitete nuk mund të jenë të kushtëzuara me plotësimin e ndonjë kushti apo të mund të plotësohen në të ardhmen pasi vetë natyra e procedurave të prokurimit është intesive dhe e kushtëzuar nga afate kohore. Në këtë kuptim KPP gjykon se kriteri për disponimin e makinerive me qera ose në pronësi është një kriter i cili nuk kufizon konkurrencën dhe aq më pak diskriminues.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-72866-05-31-2018 me objekt: “Pastrim dhe largim i mbetjeve”, me fond limit 55,705,870 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.06.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Rej” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1128 Protokoli, Datë 14.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

Mendim Kundër

Unë, Kryetarja e Komisionit të Prokurimit Publik (në vijim KPP), Evis Shurdha dhe unë Nënkryetarja e Komisionit Enkeleda Bega, jemi pjesërisht kundër arsyetimit të shumicës, për sa i përket pikës III.5.5 të vendimit për ankesën me objekt: *“Pastrim dhe largim i mbetjeve”*, me fond limit 55,705,870 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.06.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë me palë ankimuese operatorin ekonomik “Rej” shpk.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetojmë

I.1.Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Rej” shpk *“Në DT kërkohet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

- s) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-11ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 3 copë;*
- t) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 1ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 copë;*
- u) *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një)copë.*
- v) *Makine transportuese veteshkarkuese per heqijen e mbetjeve inerte te vellimshme me peshe mbajtese jo me pak se 3 ton 2 (dy) cope.*
- w) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m3, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë;*
- x) *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se 1 (një) copë;*

Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – e, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- p) *Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi).*
- q) *Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë*

objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekti këtij prokurimi).

- r) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- s) Për mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; - kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- t) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar (para, prapa, anash) në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Përcaktimi nga AK Bashkia Sarandë i vitit të prodhimit të makinerive është një kriter diskriminues dhe është në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPP. Makineritë kolaudohen nga kompania SGS Albania e cila përcakton nëse makina plotëson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave të motorit në ajër etj) sipas legjislacionit në fuqi për të qarkulluar në rrugët e RSH. Kur makineritë kolaudohen në bazë të rregullave të përcaktuara në manualin e kontrollit të mjeteve nga shoqëria SGS Albania atëherë këto makineri mund të përdoren në RSH. Vendosija e vitit të prodhimit nga AK si kusht skualifikues është një kriter diskriminues i pabzuar në VKM nr.914 datë 29.12.2014 dhe LPP. Kërkojmë heqjen e kriterit për vitin e prodhimit të mjeteve jo më pak se viti 2010. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP në vendimin KPP 748/2017.

- AK ka kërkuar provueshmërinë e disponueshmërisë së mjeteve ose me pronësi ose me qera. Ndërkohë nuk keni dhënë mundësinë e disponueshmërisë së mjeteve që mund të vihen në dispozicion me formë të ndryshme dhe konkretisht me anë të kontratës së porosisë parashikuar nga neni 914 i kodit civil ose kontratave të blerjes së mjeteve me kusht. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP në vendimin 28/2018. Kërkojmë modifikimin e kriterit duke hequr vitin e prodhimit të mjeteve dhe paraqitjen e mjeteve me kontratë porosie ose blerje me kusht”, vërejmë se,

I.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 3.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- y) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-11ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **3 copë**;
- z) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 1ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 copë**;
- aa) Makinë transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**.

bb) Makine transportuese veteshkarkuese per heqijen e mbetjeve inerte te vellimshme me peshe mbajtese jo me pak se 3 ton **2 (dy) cope.**

cc) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të **prodhimit jo më poshtë se 2010**, jo më pak se **1 (një) copë;**

dd) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **1 (një) copë;**

3. Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – e, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- u) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi).
- v) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekti këti jprokurimi).
- w) Për mjetet qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- x) Per mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; - kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- y) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar(para , prapa ,anash) në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

I.1.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

I.1.3. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

I.1.4. Referuar Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 përcaktohet:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë

I.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Kërkesa e autoritetit kontraktor që mjetet të cilat do të vihen në dispozicion të ekzekutimit të kontratës të kenë vit prodhimi 2010 , në rastin konkret është i ekzagjeruar, joproporcional dhe diskriminues pasi ndikon drejtpërdrejt në uljen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. KPP gjykon se nëse mjetet janë të pajisura me dokumentacionin e duhur dhe kanë kaluar kontrollet teknike të nevojshme që parashikon ligji janë në gjendje të realizojnë me sukses objektin e prokurimit. KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret të tepruara dhe që nuk i shërbejnë qëllimit final të autoritetit kontraktor për një realizim të suksesshëm të kontratës. E rëndësishme për autoritetin kontraktor është që operatorët ekonomikë të zotërojnë të gjitha kapacitete e nevojshme teknike në rastin konkret llojin dhe numrin e mjeteve për ekzekutimin e kontratës. Cdo kriter tjetër që tejkalon këtë qëllim është i ekzagjeruar dhe cënon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Kryetar
Evis Shurdha

Nënkryetar
Enkeleda Bega